

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gruda: PDK-ja e mban ende propozimin për nënkryetaren e Kuvendit
ADRESA	https://albeu.com/kosove/gruda-pdk-ja-e-mban-ende-propozimin-per-nenkryetaren-e-kuvendit/1009885/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 15:40:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 15:38:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e00ab61090f65b33b7f5c27c132097a9ab62228b73a09bb32a045cb7ea55f8d8
TEKSTI	7ca9d37c43063b9cb86a71b176a612dd4986e88e50a316389cda9dd64c0697e2
PAMJA	661595cd5969958b09c9ead7321ddced931b03582d56cd7387a98bdededdb87d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	03a9d8275d68313dcbe1f6353b5b13dd547678db3cd6475907c25de652a88a50
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b8dae6c54853da1d85da2cfc2b078041a9e4d965e832e711de05f684850346bc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/03a9d8275d68313dcbe1f6353b5b13dd547678db3cd6475907c25de652a88a50>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gruda: PDK-ja e mban ende propozimin për nënkryetaren e Kuvendit



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, deklaroi se institucionet e Kosovës po poshtërohen, ndërsa qytetarët po përballen me seanca të pakuptimta. Ai i bëri këto komente në një konferencë të përbashkët me deputetin Arian Tahiri, pas konstituimit të Kuvendit dhe votimit të Qeverisë "Kurti 4".

Gruda tha se PDK-ja vendosi të largohej nga seancat pasi, sipas tij, u shkelën jo vetëm afatet kushtetuese, por edhe ato të përcaktuara nga vetë Lëvizja Vetëvendosje.

"Kur kuptuam se, përveç shkeljes së afateve kushtetuese dhe atyre të vendosura nga Vetëvendosje, institucionet po poshtërohen e po fyhen, ndërsa qytetarët po tallen përmes seancave të pakuptimta, vendosëm të tërhiqemi dhe të përdorim të vetmin mjet që mund ta përdorim në demokraci, Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Për këtë arsye vendosëm të mos marrim pjesë më në seanca", deklaroi Gruda.

Sipas tij, PDK-ja nuk e ka tërhequr propozimin për kandidaten e saj për postin e nënkryetares së Kuvendit dhe, në mungesë të këtij propozimi, Kuvendi nuk mund të konsiderohet i konstituuar.

Gruda theksoi se letra e dorëzuar nga partia e tij nuk përmban tërheqje të kandidaturës, por vetëm njofton largimin e përkohshëm nga procesi deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

"Partia Demokratike e Kosovës nuk ka hequr dorë nga propozimi i kandidates së saj për nënkryetare të Kuvendit. Letra që kemi dorëzuar sot nuk nënkupton tërheqjen e propozimit, por largimin tonë të përkohshëm nga procesi derisa të vendosë Gjykata. PDK-ja nuk e ka refuzuar kandidaturën për nënkryetare të Kuvendit", tha ai.

Ai shtoi se, megjë propozimi nuk është refuzuar, Kuvendi nuk ka mundur të konstituohet dhe se procesi i zhvilluar sot është jashtë afateve dhe përcaktimeve kushtetuese, pasi mungon nënkryetarja e propozuar nga PDK-ja.

"Nëse Vetëvendosja mund ta konstituojë Kuvendin pa nënkryetaren tonë, sepse ne nuk marrim pjesë në dy

të fundit /



Samsung kërkon rrëzimin e padisë pas betejës ligjore me Du...



Video/ 27-vjeçarja hidhet nga kati i 15-të dhe bie mbi karrocën ...



PDK do ta çojë në Gjykatën Kushtetuese procesin e konstituimi...



Shpërthimi me tritol në Shkodër, autori u paraqit si shpërndarë...



Mitsotakis nga KastelORIZO: Athina kërkon dialog me...



Zemaj: Kurti paraqiti të njëjtin program, premtimet dhe...



Arsinali dhe Chelsea synojnë Raphinhan me një ofertë që i dyfisho...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

seanca, në fakt vetëm në një, pasi kjo është seanca e parë ku nuk kemi qenë, atëherë si mund të pretendojë se ka të drejtë të propozojë kryetarin e Kuvendit, kur ka munguar për dy muaj në Kuvend? Ajo ka munguar përtej afatit kushtetues dhe përtej afatit politik që e ka përcaktuar vetë. Pse Vetëvendosjes duhet t'i njihet e drejta për të propozuar kryetar Kuvendi kur e shkel Kushtetutën kaq hapur, ndërsa neve mund të na mohohet një e drejtë pse mungojmë një ditë në seancë? A duhet të mbledhet Kuvendi vetëm kur i intereson Vetëvendosjes, apo ekzistojnë rregulla? Ne jemi një shoqëri me rregulla, funksionojmë si shtet dhe Kuvendi duhet të ishte mbledhur brenda afateve", u shpreh Gruda.

Deputeti tjetër i PDK-së, Arian Tahiri, deklaroi se procesi i konstituimit të Kuvendit ka hyrë në një fazë ku nevojitet qartësi kushtetuese.

Ai bëri të ditur se të gjitha zhvillimet nga seanca konstituive dhe votimi i qeverisë së re do t'i përcillen për interpretim Gjykatës Kushtetuese.

Legjislatura e njëmbëdhjetë e Kuvendit të Kosovës u konstituua të dielën përmes votimit të nënkryetarëve, sipas kryetares së Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu.

Në seancën e sotme, Kuvendi zgjodhi Kujtim Shalën e LDK-së nënkryetar, ndërsa nga komuniteti jo serb u zgjodhën Emilja Rexhepi dhe Tanja Vujović nga Lista Serbe.

PDK-ja nuk ishte e pranishme në sallën plenare, ndërsa si rrjedhojë ishte tërhequr propozimi i Vlora Çitakut për postin e nënkryetares.

Një ditë më herët, të premten, ishte zgjedhur Ardian Gola si nënkryetar.

Po ashtu, gjatë ditës së sotme u votua edhe Qeveria "Kurti 4", e cila mori 62 vota për në një seancë të jashtëzakonshme.

Shtuar më 13.09.2026 17:38

Tags: [kandidatja](#), [pdk](#), [Përparim Gruda](#)



PDK do ta çojë në Gjykatën Kushtetuese procesin e konstituimit të Kuvendit



Zemaj: Kurti paraqiti të njëjtin program, premtimet dhe arsyetimet mbeten të...



Haxhiu: Pas formimit të Kuvendit dhe Qeverisë, duhet të zgjidhet Presidenti



Mexhiti përshëndet rizgjedhjen e Kurtit: Kosova dhe Maqedonia e Veriut ...



Donika Gërvalla: Qeveria Kurti IV nis punën me angazhim të shtuar



Qeveria Kurti 4 zyrtarizohet pas betimit



Kurti prezanton premtimet për pagat, pensionistët dhe zhvillimin ekonomik të...



Kuvendi miraton Qeverinë e re të Kosovës, Albin Kurti nis mandatin e katërt si...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.